



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOVOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644 – 25 – 2096 – 1-2-1/C1032
14 Nr. 347/25
Dt. 14.05.2025

KONTRATË FURNIZIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson: – **Ilmi Azemi – Drejtor Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**) , dhe
2. “ **Infinitt “sh.p.k.** emri biznesit, me seli në Prishtinë, me ARBK: 810860818 & “ **BMS Solutions L.L.C.** “emri i biznesit, me seli në Vushtrri, me nr. ARBK : 811557711, të cilët i përfaqëson **z. Astrit Uka**, në tekstin e mëtejme : **FURNIZUESI**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike, për furnizime , si vijon:
Furnizimi me tabela të menqura , me numër identifikues:

Nr. i prokurimit	VU644	2	5	20	9	6	1	2	1
Nr. i brendshëm	VU644	2	5	0	1	3	1	2	1

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon :
Furnizimi me tabela të menqura, për nevoja të shkollave, në pajtim me Specifikat Teknike, Kushteve të Veçanta të Kontratës dhe përshkrimit teknik të ofertës me nr. Referues : VU644-25-013-121

Neni 2 Kushtet e dërgesës

- 2.1 Afati kohor për dorëzimin e mallit është : 40 (dyzetë) ditë kalendarike nga data e nesërme pas nënshkrimit të kontratës.
- 2.2 Mbikëqyrja e cilësisë dhe sasisë së liferimit të mallit , do të bëhet nga Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës i Autoritetit Kontraktues, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Menaxherit të Kontratës, Mbikëqyrësit të Menaxherit të Kontratës , konform kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës.

- 2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

- 2.4 Kontraktuesi, para nënshkrimit të kontratës, do të dorëzoj tek A.K. Sigurimin e ekzekutimit të kontratës 10% (dhjet përqind) e vlerës së përgjithshme të kontratës. Dokumenti-Polisa e sigurimit apo dokument bankar me afat validiteti për perjudhen kohore prej 75 ditësh nga data e specifikuar për lidhjen e kontratës.
- 2.5 Garancioni për cilësinë dhe përshtatshmërinë e mallrave do të jetë përgjegjësi e Furnizuesit. Afati i garancionit fillon nga data e pranimit të mallit dhe përfundon në një afat prej minimum 24 muajve nga data e pranimit të mallit nga Mnaxheri I Kontraatës.

Dokumentit – Polisa e sigurimit e lëshuat nga një banke apo kompani e sigurimeve e licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës për kualitetin e mallit me afat validiteti për kohëzgjatjen e periudhës prej 25 muaj nga data e pranimit të mallit

Neni 3 Çmimi

- 3.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: 97,888.00€ (nëntdhjeteshtatmijetqindtëdhjetetë/00€).
- 3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër është i prerë, nuk do të nënshtrohet ndryshimeve dhe, është e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit / Kryesit të shërbimeve, sipas Kontratës.
- 3.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës, respektivisht sipas Raportit të prezantuar – dorëzuar nga Menaxheri i Kontratës si dhe Komisioni i Pranimit të mallit.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e përgjithshme dhe të Veçanta të kontratës
- (c) Aneksi 1. Specifikimet Teknike të Detyrueshme
- (c) PJESA B: Draft kontrta
- (d) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (e) Plan i për menaxhimin e kontratës;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.


5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues :
Komuna Vushtrri


Për Furnizuesin : “ Infinitt “sh.p.k. & “ BMS
Solutions L.L.C. “ – Prishtinë

Emri i ZPP	Ilmi Azemi	Emri	Astrit Uka
Pozita:	drejtor	Pozita	menaxher
Nënshkrimi:		Nënshkrimi	
Data:	14.05.2025	Data	14.05.2025
Vula:		Vula	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
14 Nr. 362/25
Dt. 15.05.2025

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik / Nr.A01, në bashkëpunim dhe propozim edhe të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese, më dt. 15.05.2025 merë:

V E N D I M

Caktohet Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës për përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që për lëndë ka: **Titulli: Blerja e tabelave te mençura per shkolla, Kodi intern i procedurës VU644-25-2096-1-2-**, si vijon :

- z. Ardian Jashari**, caktohet menaxher i kontratës
z. Alban Tahiraj, caktohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës,

1. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Neni 61 të Rregullave dhe Udhëheqësit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës.

Përgjegjësitë dhe funksionet e Menaxherit të Projektit / Kontratës, janë me sa vijon, të :

- Menaxhoi obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në Kontratë;
- Sigurojë që Op. Ek. i përmbushë të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Op. Ek. e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbushë gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë se ka kontroll adekuate të kostove, cilësisë dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- Sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së Kontratës;
- Sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;
- Nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- Jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit;
- Dorëzoj raporte mbi progresin ose kompletimin e një kontratë, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga Zyrtari Kryesor administrativ;
- Në pajtim me nenin 61.7 të rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës i A. K. duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloj me fazat e menaxhimit të projektit / Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë Menaxheri i projektit/ kontratës brenda afatit optimal/ të arsyeshëm kohorë, jo më gjatë se dy ditë pune, duhet të krijoj një Plan për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin " Fillimi / rribilizimi i kontratës". Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohej nga Sistemi i prokurimit elektronik në bashkëpunim me Menaxherit të kontratës të A.K. dhe O.E. - Kontraktuesit, duke e nënshkruar të dyja palët. Menaxheri i Projektit do ta përcjell një kopje të Planit për menaxhimin e kontratës Departamentit të Prokurimit. Pasi Zyrtari përgjegjës i Prokurimit pranon Planin për menaxhim të kontratës , Menaxheri i Projektit do ti lëshoi Op. Ek. kontraktuesit letrën për fillimin e punëve, kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të kontratës, përgjegjësi të përcaktuara si në Kushtet Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.

Përgjegjësitë dhe funksionet e Mbikëqyrësit të Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë me sa vijon:

- mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e implementimit të kontratës;
- administrimi i plotë i kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventual të kontratës, dhe
- rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit- vlerësime të propozuar nga menaxheri i kontratës nën mbikëqyrjen e tij.

2. Për Komision të Pranimi të mallit të porositur dhe të furnizuar sipas projekti Titulli: **Blerja e tabelave te mençura per shkolla**
Kodi intern i procedurës **VU644-25-2096-1-2-1**, do të emërohen komisione ad-hok në shkollat perkatese:

4. Komisioni, si në nenin 3 të këtij Vendimi, secili për pjesën e tij të përgjegjësisë, ka për detyrë të bëjë kontrollin cilësorë dhe sasiorë të furnizimeve dhe / ose shërbimeve sipas Kërkesës – Porosisë për blerje të Njesisë Kërkuese të cilën e përfaqëson, si dhe pranimin e mallit të dorëzuar, ku kryes i furnizimeve për materialin sipas përshkrimit, është **Titulli: Blerja e tabelave te mençura per shkolla**

Kodi intern i procedurës **VU644-25-2096-1-2**-cilën e përfaqëson Personi kontaktues **Burim Plakolli**

Telefoni: **044-699337- OE, në bazë të kontratës së nenshkruar.**

5. Komisioni do të filloi me punë me të pranuar të këtij Aktvendimi ndërsa do të bashkëpunoi ngushtë, në çdo kohë, me Menaxherin e Kontratës të Njesisë Shpenzuese gjegjëse si dhe Menaxherin e Kontratës të Kontraktuesit.

6. Nëse Komisioni konstaton të meta dhe/ ose parregullësi në cilësinë ose përshtatshmërinë e mallit të dorëzuar, atëherë Komisioni do të caktoj afatin për mënjanimin e parregullsive dhe / ose mangësive të konstatuara dhe të pranoi mallin pas mënjanimi të mangësive të konstatuara.

7. Nëse komisioni konstaton se nuk ka të meta, atëherë do të hartoi **Raport në të cili do të konfirmoi** përfundimin e furnizimeve të Porositura , të cilin, të nënshkruar nga anëtarët e Komisionit dhe Menaxheri i Kontratës, në afatin më të shkurtë kohorë do t'ia dërgoi, një kopje Kryesit të furnizimeve, ndërsa një kopje Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik, me qëllim të procedimit të mëtejshëm.

8. Vendimi hyn në fuqi dhe zbatohet ditën e marrjes ndërsa, për bazë do të ketë zbatimin e përpiktë të kontratës mes Autoritetit Kontraktues – **Komunës së Vushtrrisë** dhe Operatori Ekonomik : **Blerja e tabelave te mençura per shkolla**

Kodi intern i procedurës **VU644-25-2096-1-2-1.**


Kopje: 1 x 1 Menaxheri i Kontratës;

1 x 1 Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës;

1 x 1 Komisionit të pranimi të mallit;

1 x 1 Drejtorisë së Prokurimit.

Ferit Idrizi


Kryetar i Komunës



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. **138817**

Për **KOMUNA E VUSHTRRIË**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **Konzorciumi INFINITT SH.P.K.& BMS SOLUTIONS L.L.C.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Blerja e tabelave te mençura per shkolla**

Nr. prokurimit: VU644-25-2096-1-2-1

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **9,788.80€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **9,788.80€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 75 ditë kalendarike prej **14.05.2025** deri më **28.07.2025**

Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përmbushjen e tërësishme të detyrimeve.

Data lëshimit: 13.05.2025

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G

F ju duhet të plotësoni duke shkruar normenë e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8 apo 18, e jo në formatin ~~0%,8%apo18%~~

plotësoni me çmimin për njësi me TVSH.

pas presjesë dhjetore, në të kundërtën nuk do të merret për bazë numri i tret pasë presjes

Ndërsa në ko
Çmimi duhet të shkruhet n

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSh)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH
1	Blerja e tabelave te mençura per shkolla sipas modelit I	copë	28.00	1728.70	8.00	1,867.00	48,403.70	3,872.30

Blerja e tabelave te mençura per shkolla sipas modelit II	copë	28.00	1508.33	8.00	1,629.00	42,233.33	3,378.67
TOTALI I PËRGJITHSHËM:						90,637.04	7,250.96

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	INFINITT SH.P.K.
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	Astrit Uka
NËNSHKRIMI:	
DATA:	08.04.2025.
VULA:	

Në kolonën
lonën G, duhet ta
ie dy decimale

Totali (me TVSH)-€	52,276.00
-------------------------------	------------------

45,612.00
97,888.00

AUTORITETI KONTRAKTUES

KOMUNA E VUSHTRRISE, SHESHI " HASAN PRISHTINA" NR 173, 42000, VUSHTRRI,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: VU644-25-2096-1-2-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: Grup i Operatorëve Ekonomik INFINITT SH.P.K.; BMS SOLUTIONS L.L.C., Dëshmorët e Kombit, 10000, PRISHTINË, Kosovë

E-mail: infinitt.shpk@gmail.com

Personi kontaktues: Astrit Uka

Telefoni: 044/974-590

Faxi: /

Numri fiskal:

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

Partneri 1.

Emri i kompanisë: " INFINITT " SH.P.K.

Numri fiskal: 601614177

Vend-Selia: Dëshmorët e Kombit, 10000, PRISHTINË, Kosovë

Partneri 2.

Emri i kompanisë: BMS SOLUTIONS L.L.C.

Numri fiskal: 811557711

Vend-Selia: Mehmet Akifi nr .14, 42000, Vushtrri, Kosovë